

LD منظمة اطباء العالم LÄKARE I VÄRLDEN MEDICI DEL MON
MÉDICOS DO MUNDO MÉDICOS DEL MUNDO 世界の医療団
世界医生组织 DOCTORS OF THE WORLD منظمة أطباء العالم
DOKTERS VAN DE WERELD MÉDICOS DO MUNDO
के डॉक्टर MÉDECINS DU MONDE 世界医生组织 DOCTORS
I DEL MONDO ΓΙΑΤΡΟΙ ΤΟΥ ΚΟΣΜΟΥ DOKTERS VAN DE
ELT दुनिया के डॉक्टर MÉDECINS DU MONDE 世界医生组织 DO

Në bashkëpunim me



BritishRedCross



FLETË- INFORMACIONI MBI VAKSINËN E GRIPIT PËR EMIGRANTËT NË ANGLI 2020-2021

SHQIP | ALBANIAN



ÇFARË ËSHTË VAKSINA E GRIPIT? Vaksina e gripit:

- është e sigurt dhe e efektshme
- ju mbron ndaj gripit dhe komplikacioneve të tij
- nuk është vaksinë për koronavirusin
- është falas për disa grupe në bazë të kushteve të tyre klinike ose moshës, por të gjithë mund ta marrë atë
- është shumë e rëndësishme që ta merrni nëse kualifikoheni

KUSH MUND TA MARRË VAKSINËN E GRIPIT? Kushdo që:



është 50 vjeç a lart



ka shqetësime të caktuara shëndetësore, që mund të rrisin rrezikun e prekjes nga gripi si astmë, mbipeshë, diabet dhe probleme të zemrës



është shtatzënë



jeton në një shtëpi për të moshuarit



është kujdestari kryesor për një të moshuar ose person me aftësi të kufizuara, që mund të jetë në rrezik nëse sëmurëni



fëmijët që janë 2 dhe 3 vjeç



fëmijët e shkollës fillore dhe nxënësit e vitit të parë të shkollës së mesme (që kanë lindur para datës 31 gusht 2009)



kushdo ndërmjet moshës 2 - 17 vjeç me probleme shëndetësore afatgjatë si astmë, diabet, sistem të dobësuar imunitar, probleme të zemrës dhe me aftësi të kufizuara të të mësuarit



jeton me dikë që është mjaft i rrezikuar nga koronavirusi (kategori e mbrojtur)

* Nëse nuk i përkisni ndonjërit prej këtyre grupeve, ju mund ta blini vaksinën e gripit në farmaci. Kostoja minimale është £8, por mund të jetë më e lartë në varësi të llojit dhe markës së vaksinës së disponueshme në farmacinë tuaj.

KU MUND TA MERRNI VAKSINËN E GRIPIT?

- Pranë klinikës së mjekut të familjes (GP)
- Pranë një farmacie që e ofron këtë shërbim
- Pranë shkollave për fëmijët e kualifikuar
- Pranë shërbimit të kujdesit të mamisë, nëse jeni shtatzënë

SI MUND TA MERRNI VAKSINËN E GRIPIT?



Nëse kualifikoheni për vaksinën e gripit, Shërbimi Kombëtar i Kujdesit Shëndetësor (NHS) mund t'ju njoftojë përmes postës, SMS-ve ose telefonit për të marrë vaksinën e gripit.



Nëse jeni regjistruar në një GP*, mund të komunikoni direkt me të dhe të pyesni rreth vaksinës së gripit dhe nëse mund ta merrni atë. Është shumë e rëndësishme që të gjithë të regjistrohen në GP.



Ju gjithashtu mund të pyesni farmacistin tuaj rreth vaksinës së gripit, nëse ai është i njohur me gjendjen ose historikun tuaj mjekësor. Nëse farmacisti nuk është i njohur me gjendjen ose historikun tuaj mjekësor, ai mund t'ju kërkojë një vërtetim të kualifikimit tuaj.



Për fëmijët që kualifikohen, shkolla do të komunikojë me prindërit ose kujdestarët dhe do t'u dërgojë atyre informacionin e nevojshëm për datat dhe orët e vaksinimit, së bashku me një formular të pëlqimit. Prindërit ose kujdestarët duhet të nënshkruajnë formularin e miratimit që fëmijët e tyre të marrin vaksinën.

Të gjithë ofruesit e vaksinës do të ndjekin udhëzime rigoroze që ju ta merrni vaksinën e gripit në mënyrë të sigurt.

*Kushdo që jeton në Mbretërinë e Bashkuar ka të drejtën të regjistrohet në një GP (Mjeku i familjes), pavarësisht statusit të imigracionit ose mundësisë për të paraqitur një ID ose vërtetim adrese. Nëse keni nevojë për ndihmë për t'u regjistruar në një GP, kontaktoni linjën telefonike falas të Doktorëve të Botës në nr. 0808 1647 686 - nga e hëna në të premten, nga ora 10:00 deri në orën 12:00 të mesditës.

A ËSHTË HALLALL VAKSINA E GRIPIT?

Janë disa lloje vaksinash gripi në dispozicion: disa janë me injeksion dhe të tjerat me spërkatje. Individëve u ofrohet vakcina që u rekomandohet në varësi të moshës ose rrezikut të tyre. Vakcina e gripit, që u jepet fëmijëve nga 2 vjeç e lart dhe duke përfshirë ata të moshës 11-12 vjeç, përmban xhelatinë derri. Megjithatë, ju mund të kërkonte një vaksinë tjetër nëse jeni kundër saj bazuar në besimet fetare ose spirituale.

Për më shumë informacion në lidhje me vaksinën e gripit, vizitoni faqen e internetit:

<https://www.gov.uk/government/publications/flu-vaccination-who-should-have-it-this-winter-and-why>